



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 50
Prishtinë, më 10.11.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Salih Salihu, Shaip Muja, Time Kadrijaj dhe Haxhi Shala.

Munguan: Murat Hoxha, Sergjan Popoviç.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.11.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për zhurmën;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.11.2016

Procesverbali i mbledhjes dt. 1.11.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Zhurmën

Kryetarja **Duda Balje** kërkoi votimin një nga një të amendamenteve të deritanishme të cilat u miratuan si vijon :

- **Amendamenti nga ish deputetja Alma Lama** që titulli “**Ligji për mbrojtjen nga zhurma**” të ndryshohet me : “**Ligji për mbrojtjen e shëndetit nga zhurmat mjedisore**” dhe kudo në tekstin e projektligjit në vend të termit zhurmë të perdoret “**zhurmë mjedisore**”, ishte **pa përkrahjen e Komisionit**, si dhe
- **Amendamenti nga ish deputetja Alma lama te Neni 3, paragrafi 1.1.** riformulimi : **Zhurmë mjedisore** është çdo tingull, i padëshiruar apo i dëmshëm, i lëshuar nga veprimtaritë njerëzore, përfshirë zhurmën e lëshuar nga mjetet e transportit, nga trafiku rrugor, hekurudhor, ajror dhe nga sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale, të cilat janë objekt i këtij ligji, gjithashtu ishte **pa përkrahjen e komisionit.**

Deputeti Adem Salihaj propozoi që propozimet e tij mos të veçohen dhe të evidentohen në emër të komisionit, çka edhe miratoi Komisioni disa nga propozimet e tij.

Amendamenti 1

Neni 1, paragrafi 2 dhe 3 ndryshohen në renditje, paragrafi 2 bëhet paragraf 3, ndërsa paragrafi 3 bëhet paragraf 2.

Amendamenti 2

Neni 2, në fund fshihen fjala “**senzitive**” dhe **klapat**.

Amendamenti 3

Neni 3,

Paragrafi 1.15, fshihet pjesa e fjalise “...e cila ka me shume se tre milion (3.000.000) levizje te automjeteve ne vit.”

Paragrafi 1.16 riformulohet si vijon:

Hekurudha kryesore- hekurudha e percaktuar si e tille nga organi kompetent.

Paragrafi 1.17 riformulohet si vijon :

Aeroporti kryesor- aeroport i percaktuar si i tillë nga organi kompetent.

Paragrafi 1.22, fjalët ne kllapa hiqen ne tërësi.

Amendamenti 4

Neni 4, në fund të paragrafit 1, shprehja “**etj**” fshihet.

Amendamenti 5

(Amendament nga ish deputetja Alma Lama **i përkrahur nga Komisioni**)

Neni 6, paragrafi 2.6. fshihet.

Amendamenti 6

Neni 9, paragrafi 3, riformulohet :

Vlerat kufitare të zhurmës përcaktohen me Shtojcën VIII, e cila është pjesë përbërëse e këtij ligji.

Amendamenti 7

Neni 11, paragrafi 8, riformulohet :

Zhurma në zonat akustike, nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk lejohet të tejkalon vlerat kufitare të zhurmës, të paraqitura në Shtojcës VIII të këtij Ligji.

Pas paragrafit 8, shtohet paragrafi i radhës :

9. Në afat prej tri (3) viteve prej datës së miratimit të këtij ligji, për zonat akustike, objektet dhe paisjet egzistuese Komunitat, autoritetet përgjegjëse për rrugët kryesore, hekurudhat dhe aeroportet duhet të i arrijnë vlerat kufitare të paraqitura në Shtojcën VIII të këtij ligji.

Amendamenti 8

Neni 14, Paragrafi 2, fjala “**bjen**” zëvendësohet me “**nxjerr**”.

Paragrafi 5, fjala “**neni 6**” zëvendësohet me “**Neni 5**”.

Amendamenti 9

Neni 16, paragrafi 1, “**nenit 16**” zëvendësohet me “**Nenit 15**”.

Amendamenti 10

Neni 17, pas paragrafit 1.2 shtohet numri 2 para fjalës **Hartat**.

Amendamenti 11

Neni 18, paragrafi 1 riformulohet :

1.Komunitat duhet të përgatitin hartën strategjike të komunës, ndërsa autoritetet

kompetente duhet të përgatitin hartën strategjike për rrugët kryesore, hekurudhat kryesore dhe aeroportet kryesore.

Amendamenti 12

Neni 19,paragrafi 1.1 riformulohet si vijon :

Zonat pranë rrugëve kryesore , hekurudhave kryesore dhe aeroporteve kryesore.

Neni 19,paragrafi 1.2 riformulohet si vijon:

Aglomeratet, dhe zonat. Planet e tilla synojnë mbrojtjen e zonave të qeta ndaj rritjes së nivelit të zhurmës.

Amendamenti 13

Neni 24, paragrafi 1, “neni 24” bëhet “Neni 23”.

Amendamenti 14

Neni 26, paragrafi 1 riformulohet :

Në zbatimin e inspektimit, inspektori mjedisor i planifikimit hapësinor komunal, obligohet që në rast të shkeljes së ligjit ose akteve nënligjore të dala nga ky ligj, të ndërmer masa administrative për veprimet e cekura më poshtë :

Amendamenti 15

Neni 27 riformulohet :

Kundërvajtjet

1. Të gjithë personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose me aktet e nxjerra në bazë të këtij ligji, do të dënohen për kundërvajtje, dhe atë; personi fizik prej dyqind (200) deri njëmijë (1.000) Euro, ndërsa personi juridik prej dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse :

1.1. nuk siguron mbrojtje nga zhurma, sipas nenit 5 te këtij ligji;

1.2. nuk ndërmerren masat e parapara gjatë kryerjes së veprimtarive dhe aktiviteteve, të cilat ndikojnë apo mund të ndikojnë në tejkalimin e vlerave kufitare të përcaktuara të zhurmës, në mjedis, sipas nenit 9 dhe 10 te këtij ligji;

1.3. shkakton zhurmë në zonat akustike mbi vlerat kufitare të zhurmës, tejkalohen vlerat kufitare të zhurmës nga pajisjet elektro-akustike në objekte hotelierike, nga ndërtimi dhe aktivitetet tjera në një zonë të caktuar, sipas paragrafit 4, 6, 7 dhe 8 të nenit 12 te këtij ligji;

1.4. lëshon në treg dhe përdor burimet e zhurmës, tek të cilat fuqia e zërimit tejkalon vlerat kufitare të përcaktuara me nenin 13 te këtij ligji;

1.5. shkaktohet zhurmë në mjedis mbi vlerat kufitare të përcaktuara me paragrafin 2 dhe 4 të nenit 15 te këtij ligji;

- 1.6. kryen matjet e nivelit të zhurmës pa licencë të lëshuar nga Ministria, sipas paragrafit 1 të nenit 18 të këtij ligji;
2. Me gjobë prej pesqind (500) deri në dyëmijë (2000) Euro, dënohen personat fizik, ndërsa personi juridik prej katërmijë (4.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, të cilët edhe pas gjobitjes nga paragrafi 1 i këtij neni nuk kanë përmbush kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni.
3. Eksperti licencuar për zhurmë në mjedis sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 18 të këtij ligji, i cili jep të dhëna, deklarata të pavërteta dhe informata të rreme, i merret licenca.

Amendamenti 16

Pas Neni 27 shtohet Neni i ri :

E drejta e ankesës

1. Kundër vendimit të inspektoratit lejohet ankesë në afat prej tetë (8) ditëve kalendarike nga dita e dorëzimit të vendimit.
2. Lidhur me ankesën kundër vendimit të inspektoratit vendos Minsitria.
3. Ministria është e detyruar që në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e paraqitjes së ankesës të vendos për ankesën e ushtruar kundër vendimit të inspektoratit.
4. Kundër vendimit të Ministrisë, mund të parashtrohet padi në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve.

Amendamenti 17

Neni 28, paragrafi 4, numri 18 zëvendësohet me 6.

Amendamenti 18

Neni 29, numri romak “VI” bëhet “VIII”.

Amendamenti 19

Pas shtojcës VI, shtohen Shtojca VII, Klasifikimi i zonave akustike dhe “Shtojca VIII, Vlerat kufitare të zonave akustike.(Abstenoj Emilija Redzeqi).

Shtojca VII Klasifikimi i zonave akustike

Zona akustike e I	Në këtë klasë janë të gjitha zona të mbrojtura, ku qetësia është elementi kryesor. Në këtë klasë hyjnë zonat e spitaleve, shkollave, parqevet, vend zonat e banimit
-------------------	---

Zona akustike e II	Në këtë klasë janë të gjitha zonat rezidenciale, me dendësi të ulët të banorëve. Në këto zona është vetëm trafiku lokal, nuk ka industri dhe ka vetëm disa aktivitete tregtare
Zona akustike e III	Në këtë klasë zonat quhen të përziera. Këto zona karakterizohen si nga trafiku lokal dhe atij kalimtar, me dendësi mesatare të banorëve, aktivitete komerciale dhe zyra, por pa industri
Zona akustike e IV	Në këtë klasë janë zonat me veprimtari të larta njerëzore, dendësi të lartë të banorëve, trafikut rrugor, aktivitete të shumta tregtare; këto zona janë afër rrugëve kryesore dhe hekurudhave kryesore; në këto zona mund të jenë edhe disa industri të vogla
Zona akustike e V	Në këtë klasë hyn kryesisht zonat industriale. Në këto zona janë industritë dhe dhe vendbanime me dendësi të ulët të banorëve
Zona akustike e VI	Në këtë klasë hyn vetëm zonat industriale. Në këto zona janë vetëm industritë; nuk ka banesa në këto zona

Shtojca VIII Vlerat kufitare të zonave akustike

Klasifikimi i zonave akustike	Periudha referente	
	Dita (7:00h- 23.00h)	Nata (23:00h- 7:00h)
Zona akustike e I ^{re}	50dB	40 dB
Zona akustike e j ^{red}	55 dB	45 dB
Zona akustike e III ^{re}	60 dB	50 dB
Zona akustike e IV ^{re}	65 dB	55 dB
Zona akustike e V ^{re}	70 dB	60 dB
Zona akustike e VI ^{re}	70 dB	70 dB

5. Të ndryshme

Kryetarja në kuadër të pikës të ndryshme ftoi drejtorin e ARRU z. **Raif Preteni** i cili ka kërkuar këshillë juridike nga Komisioni lidhur me nxjerrjen e Rregullores për masa ndëshkuese të cilin veprim ai është me dyshim se mundet ta bëjë në bazë të Ligjit në fuqi, ndaj **Kryetarja** falënderoj drejtorin për informim për këtë çështje dhe premtoi të njëjtit se komisioni do të kërkojë këshilla ligjore për këtë çështje, pasi të kompletoi shkresën të cilin do të dorëzoi stafit për procedim për këtë këshillë ligjore.

Gjithashtu në vazhdim komisioni bëri konsultime rreth iniciativës së deputetit Adem Salihaj rreth informatës për fidanet e mjedrave për të cilën temë do të caktohet mbledhja e komisionit pas vizitës së Komisionit në Bullgari.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje